



KUVENDI I SHQIPËRISË
KRYETARI

Nr. 84/12 Prot.

Tiranë më 08, 04 2017

Lënda: Njoftimi i mbledhjes së seancës plenare për krijimin dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* të verifikimit të kandidatëve dhe kërkesa për propozimin për përbërjen e këtij komisioni *ad hoc*, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Drejtuar:

Zotit: Gramoz RUÇI

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Zotit: Edi PALOKA

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike

Zotit: Luan RAMA

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim

Zonjës: Mesila DODA

Kryetare e Grupit Parlamentar të Partisë për Drejtësi, Integrim, Unitet

Zotit: Fatmir MEDIU

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane

Këtu

Bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 18/2017, datë 16.3.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit”, Avokati i Popullit me shkresën nr. 104 Prot, datë 7.4.2017, ka dërguar listën e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listën e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale, dhe listën e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për institucionet e rivlerësimit, si dhe dosjet e seçilit kandidat, marrja në dorrëzim e të cilave prej përfaqësuesve të shërbimeve të Kuvendit ka përfunduar më datë 08.04.2017.

Në zbatim të nenit 8 pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” njoftoj mbledhjen e seancës plenare **ditën e martë, datë 11 Prill 2017, ora 18.00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i projektvendimit “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Miratimi i projektvendimit të Kuvendit “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër, Ju lutem, **brenda datës 11 Prill 2017, ora 16.00** dërgoni propozimet Tuaja për përbërjen e komisionit parlamentar *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve. Ky komision përbëhet nga 6 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

